Sa i përket tokës, problematikat kryesore lidhen me degradimin e tokës bujqësore nga ndërtimet pa planifikim, eksploatimi i materialeve inerte dhe krijimi i deponive ilegale të mbeturinave. Këto dukuri kanë ndikuar në humbjen e sipërfaqeve produktive dhe në dëmtimin e peizazhit natyror.

Komuna e Pejës karakterizohet me biodiversitet dhe zona të rëndësishme natyrore, sidomos Parku Kombëtar i Bjeshkëve të Nemuna dhe Gryka e Rugovës, të cilat kanë rëndësi të veçantë ekologjike dhe turistike. Megjithatë, prerjet ilegale të pyjeve, erozioni dhe presioni urban paraqesin rrezik për ekosistemet natyrore.

Menaxhimi i mbeturinave mbetet sfidë për komunën, për shkak të mungesës së sistemit të plotë të riciklimit dhe pranisë së deponive ilegale në disa zona rurale dhe periferike. PZHK parasheh masa për përmirësimin e infrastrukturës mjedisore, trajtimin e ujërave të zeza, shtimin e hapësirave të gjelbra dhe mbrojtjen e zonave natyrore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm të komunës.

5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT

5.1.Përshkrimi i alternativave të realizueshme

Gjatë hartimit të projektit për eksploatimin e materialeve inerte nga kompania “Gashi” Sh.p.k. në territorin e Komunës së Pejës, janë analizuar alternativa të ndryshme me qëllim identifikimin e zgjidhjes më të përshtatshme nga aspekti teknik, ekonomik dhe mjedisor. Vlerësimi i alternativave është bërë duke marrë parasysh karakteristikat e terrenit, qasjen infrastrukturore, ndikimet potenciale në mjedis dhe përputhshmërinë me dokumentet planifikuese dhe legjislationin në fuqi.

Alternativa 1 – Mosrealizimi i projektit (Alternativa Zero) - Kjo alternativë parasheh moszhvillimin e aktivitetit të eksploatimit dhe ruajtjen e gjendjes ekzistuese të zonës. Edhe pse në këtë rast shmangen ndikimet direkte në mjedis nga aktiviteti minerar, nuk realizohet shfrytëzimi ekonomik i resurseve minerare dhe nuk krijohen përfitime ekonomike apo mundësi punësimi për komunitetin lokal. Gjithashtu, mungon furnizimi me materiale inerte të nevojshme për sektorin e ndërtimit dhe zhvillimin infrastrukturor.

Alternativa 2 – Realizimi i projektit në lokacionin e propozuar - Kjo alternativë përfshin zhvillimin e aktivitetit minerar në parcelën e planifikuar për eksploatim, duke përdorur metodën sipërfaqësore të nxjerrjes së materialeve inerte. Lokacioni konsiderohet i përshtatshëm për shkak të karakteristikave të favorshme gjeologjike, qasjes së mirë rrugore dhe distancës së pranueshme nga zonat e banuara. Aktiviteti do të realizohet duke zbatuar masa mbrojtëse për kontrollin e pluhurit, zhurmës dhe degradimit të tokës, si dhe masa rehabilituese pas përfundimit të punimeve.

Alternativa 3 – Zhvendosja e projektit në një lokacion tjetër - Kjo alternativë parasheh realizimin e aktivitetit në një zonë tjetër brenda territorit komunal. Megjithatë, lokacionet alternative mund të kërkojnë investime shtesë për infrastrukturë dhe qasje rrugore, si dhe mund të kenë ndikime më të mëdha në tokë bujqësore, peizazh natyror ose në afërsi të vendbanimeve. Për më tepër, mungesa e kushteve të përshtatshme teknike dhe ekonomike e bën këtë alternativë më pak të favorshme.

Alternativa 4 – Eksploatim me kapacitet të reduktuar - Kjo alternativë përfshin zhvillimin e aktivitetit me intensitet më të ulët të eksploatimit dhe me volum më të vogël të nxjerrjes së materialit. Kjo do të reduktonte ndikimet në mjedis, veçanërisht emetimin e pluhurit, zhurmën dhe degradimin e terrenit, por njëkohësisht do të ulte efikasitetin ekonomik dhe kapacitetin furnizues të projektit.

Pas analizës së alternativave të mundshme, alternativa e realizimit të projektit në lokacionin e propozuar vlerësohet si zgjidhja më e përshtatshme, pasi siguron shfrytëzim racional të burimeve minerare, realizueshmëri ekonomike dhe ndikime të menaxhueshme në mjedis përmes zbatimit të masave mbrojtëse dhe rehabilituese.

5.2. Përshkrimi i alternativave të realizueshme përmban edhe përshkrimin e arsyeve kryesore për zgjedhjen e një alternative të caktuar duke ju referuar

Alternativa 2 përfshin realizimin e projektit në parcelat brenda lokacionit të propozuar, duke nxjerr materialet inerte dhe efikasitetin operativ. Kjo alternativë lejon organizimin e punimeve dhe transportit të makinerive në mënyrë të kontrolluar, vendosjen e masave mbrojtëse për pluhurin, zhurmën dhe menaxhimin e ujërave sipërfaqësorë, dhe respektimin e distancave të sigurta nga banesat më të afërta (420 m) dhe burimet ujore. Sipas raportit të VNM-së, kjo alternativë konsiderohet e realizueshme dhe e qëndrueshme, duke balancuar kapacitetin operativ, minimizimin e ndikimeve mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit në zonën e projekti.

5.3. Vendndodhja ose rruga

Zona e projektit për shfrytëzimin e materialeve inerte ndodhet në parcelën nr. 05611-0, në zonën kadastrale Pejë, Komuna e Pejës. Vendndodhja është e lidhur me rrjetin ekzistues rrugor, duke përfshirë rrugën tranzit që kalon 200 metra larg parcelës dhe rrugën regjionale Pejë–Klinë në distancë rreth 1 km, duke mundësuar qasje të lehtë dhe të sigurt për transportin e materialeve. Rruga për qasje në parcelë është e asfaltuar dhe e përshtatshme për lëvizjen e mjeteve të rënda që përdoren gjatë nxjerrjes dhe transportit të materialeve inerte. Brenda zonës së punimeve janë planifikuar platot dhe rrugët e brendshme operative për qarkullim të kontrolluar, duke minimizuar ndërhyrjet në zonat përreth dhe duke siguruar siguri për personelin dhe komunitetin lokal.

Vendndodhja dhe rruga e propozuar për nxjerrjen e materialeve është zgjedhur në mënyrë që të sigurohet efikasitet maksimal i punimeve dhe minimizimi i ndikimeve mjedisore dhe sociale, duke respektuar distancat nga banesat dhe burimet ujore përreth

5.4. Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut

Aktiviteti i shfrytëzimit të materialeve inerte mund të ndikojë në disa komponentë të mjedisit dhe të shëndetit publik. Sipas raportit të VNM-së, ndikimet kryesore identifikohen si më poshtë:

Ajri: Gjatë nxjerrjes dhe transportit të materialeve, mund të gjenerohet pluhur, i cili mund të ndikojë në cilësinë e ajrit në zonën përreth parcelës. Masat mbrojtëse të propozuara përfshijnë

spërkatjen me ujë të rrugëve dhe sipërfaqeve operative për të reduktuar shpërndarjen e grimcave në ajër.

Uji: Aktivitetet mund të shkaktojnë shpërndarje të grimcave në ujërat sipërfaqësorë dhe përroskat e afërta, përfshirë lumin Lumbardhi të Pejës (270 m larg). Përdorimi i ujit për kontrollin e pluhurit dhe menaxhimi i ujërave të larguara nga zona e punimeve minimizojnë ndotjen e ujërave.

Toka: Ndikimet mbi tokën lidhen me zhvendosjen e materialeve dhe mundësinë e erozionit. Masat e rekomanduara përfshijnë organizimin e punimeve brenda parcelës dhe rehabilitimin e sipërfaqeve pas përfundimit të operimeve.

Zhurma dhe siguria: Makineritë e përdorura për nxjerrje dhe transport mund të shkaktojnë zhurmë, e cila mund të ndikojë mbi komunitetin lokal dhe personelin. Distanca minimale nga ndertesa e banimit (420 m) dhe përdorimi i rrugëve të brendshme operative reduktojnë efektet negative.

Shëndeti i njeriut: Ndikimet kryesore lidhen me ekspozimin ndaj pluhurit dhe zhurmës. Masat mbrojtëse, distancimi nga banesat dhe monitorimi i vazhdueshëm i operimeve sigurojnë që rreziqet për shëndetin e banorëve dhe punonjësve të mbeten minimale.

Sipas raportit të VNM-së, zbatimi i masave mbrojtëse, monitorimi dhe organizimi i punimeve brenda parcelës mundësojnë që ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut të jenë të kontrolluara dhe të pranueshme. Kjo garanton që projekti të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme dhe të sigurt për komunitetin lokal

5.5.Proceset dhe teknologjia e prodhimit

Procesi i shfrytëzimit të materialeve inerte nga kompania “Gashi” Sh.p.k. zhvillohet në parcelën nr. 05611-0, duke përdorur teknologji të përshtatshme për nxjerrjen dhe transportin e materialeve. Operimi përfshin këto faza kryesore:

- **Gërmimi dhe nxjerrja e materialeve:** Materialet inerte si rëra dhe zhavorri nxirren nga terreni me makineri të specializuar, duke respektuar kufijtë e parcelës dhe distancat nga banesat dhe burimet ujore.
- **Transporti i materialeve:** Materialet e nxjerra transportohen jashtë zonës për përpunim të mëtejshëm ose dërgohen në destinacione të jashtme për ndërtim. Rrugët operative brenda parcelës dhe rruga tranzit pranë parcelës (200 m larg) sigurojnë qarkullim të kontrolluar dhe efikas.

- **Kontrolli mjedisor:** Gjatë të gjithë procesit përdoren masa mbrojtëse për kontrollin e pluhurit (spërkatja e sipërfaqeve me ujë), menaxhimin e ujërave sipërfaqësorë dhe monitorimin e zhurmës.
- **Ruajtja e përkohshme dhe transporti:** Materiali i nxjerrë mund të vendoset përkohësisht në hapësirën e përcaktuar brenda parcelës, pa iu nënshtuar përpunimit. Më pas, ai ngarkohet në kamionë dhe transportohet drejt destinacionit përfundimtar ose te operatorët e tjerë për përpunim të mëtejshëm. Materiali nuk thërmohet, nuk seleksionohet dhe nuk lahet në lokacion.

Teknologjia e përdorur është standarde për sektorin e nxjerrjes së materialeve inerte, duke kombinuar efikasitetin operacional me masat mbrojtëse mjedisore. Ky kombinim siguron që prodhimi të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme dhe me ndikim minimal mbi komunitetin dhe mjedisin përreth.

5.6. Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit

Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit përshkruajnë mënyrën praktike të organizimit dhe kryerjes së operacioneve në zonën e eksploatimit të materialeve inerte.

Nxjerrja e materialeve si rërë dhe zhavorr realizohet në terren të hapur duke përdorur makineri të rënda (eskavatorë, ngarkues frontal, kamionë transportues). Procesi ndjek një rrjedhë të thjeshtë: gërmimi i materialit, ngarkimi direkt në kamionë dhe transporti drejt destinacioneve për përpunim ose përdorim ndërtimor. Materiali nuk i nënshtrohet thërrmimit, seleksionimit, larjes apo trajtimeve të tjera.

Lëvizja e makinerive dhe kamionëve është e kontrolluar brenda korridoreve të përcaktuara për të reduktuar pluhurin, dëmtimin e tokës dhe shpërndarjen jashtë zonës së punës. Orari i punës është i kufizuar gjatë ditës për të minimizuar zhurmën dhe shqetësimin për popullatën. Për sipërfaqet e punës dhe rrugët e brendshme përdoret ujitje për të zvogëluar pluhurin. Makineritë i nënshtrohen mirëmbajtjes së rregullt për të reduktuar zhurmën dhe për të ruajtur funksionimin e qëndrueshëm.

Operacionet nuk prodhojnë mbetje teknologjike, nuk përdorin ujë teknologjik dhe nuk kërkojnë përdorim të energjisë përveç asaj të makinerive. E gjithë qasja fokusohet në nxjerrjen dhe transportin e materialit pa ndërhyrje shtesë.

Në thelb, metoda është lineare dhe e thjeshtë, me theks në menaxhimin e ndikimeve mjedisore si pluhuri, zhurma dhe ruajtja e strukturës natyrore të tokës, duke siguruar që aktiviteti të realizohet në mënyrë të qëndrueshme dhe të kontrolluar.

5.7. Plani i lokacionit

Plani i lokacionit për zonën e eksploatimit të inerteve paraqet organizimin funksional të hapësirës shfrytëzuese të inerteve. Ai përfshin:

- Frontet e punës për nxjerrjen e masës shkëmbore;
- Hapësirat për ngarkimin e materialit me ekskavatorë;
- Rrugët e brendshme për qarkullimin e kamionëve dhe makinerive;
- Zonat për manovrim dhe parkim të përkohshëm të pajisjeve.

Qarkullimi brenda zonës është i organizuar në mënyrë të qartë, me hyrje dhe dalje të kontrolluara për mjetet transportuese, duke siguruar lidhje të drejtëpërdrejtë me rrjetin rrugor ekzistues dhe me separacionin e kompanisë.

5.8. Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit

Materialet kryesore të përdorura janë natyrore, të nxjerra direkt nga terreni, pa u përpunuar: rërë dhe zhavorr, në varësi të karakteristikave gjeologjike të zonës. Këto materiale shërbejnë për qëllime ndërtimore dhe infrastrukturore, si beton, asfalt dhe punime të tjera konstruktive. Materialet ndihmëse përfshijnë karburant, lubrifikantë dhe ujë për zvogëlimin e pluhurit gjatë operacioneve. Të gjitha materialet zgjidhen në mënyrë që të sigurohet efikasiteti i punimeve, të minimizohet ndikimi në mjedis dhe të ruhet qëndrueshmëria e ekosistemit.

Në përzgjedhje është marrë parasysh cilësia e materialeve, disponueshmëria në zonë dhe përdorimi i tyre pa nevojën për trajtime shtesë, duke e bërë procesin linear dhe të thjeshtë: nxjerrje, ngarkim dhe transport drejt destinacionit përfundimta

5.9. Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit

Projekti për zonën e eksploatimit të inerteve nuk përfshin fazë ndërtimi të objekteve industriale, por vetëm punë përgatitore në terren, të cilat parashihet të realizohen brenda një periudhe të shkurtër kohore, në varësi të sipërfaqes dhe kushteve në terren. Ky proces zakonisht planifikohet të kryhet brenda disa ditëve deri në disa javë, varësisht nga madhësia e parcelës dhe kapaciteti i makinerive. Për zonën e kompanisë, me parcelën 05611-0 dhe sipërfaqe të standardizuar për nxjerrjen e inerteve, afati paraprak për rregullimin e zonës dhe gatishmërinë për fillimin e nxjerrjes është rreth 1–2 javë pune intensive. Pas përfundimit të punëve përgatitore, aktiviteti i nxjerrjes së inerteve do të zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me planin e miratuar dhe me kapacitetin e lejuar të nxjerrjes. Afati i operimit është afatgjatë dhe lidhet drejtpërdrejt me vlefshmërinë e lejes minerare, pëlqimit mjedisor dhe autorizimeve të tjera përkatëse sipas legjislacionit në fuqi. Funksionimi i projektit do të

vazhdojë për aq kohë sa ekzistojnë rezerva minerare të shfrytëzueshme dhe përmbushen kërkesat ligjore, teknike dhe mjedisore.

Pas përfundimit të eksploatimit, do të realizohet faza e mbylljes dhe rehabilitimit të zonës, në përputhje me planin e mbylljes së zonës dhe detyrimet e përcaktuara nga autoritetet kompetente.

5.10. Madhësia e lokacionit ose objektit

Zona e eksploatimit të inerteve shtrihet në një sipërfaqe prej 0.685 ha. Kjo sipërfaqe përfshin frontet e punës, rrugët e brendshme për lëvizjen e makinerive dhe kamionëve, hapësirat për ngarkim dhe manovrim, si dhe zonat e rehabilitimit pas përfundimit të punimeve. Organizimi i hapësirës siguron që aktivitetet të kryhen në mënyrë të kontrolluar, duke shmangur ndërhyrje të panevojshme në tokën përreth dhe duke lejuar një qarkullim të efektshëm të mjeteve.

5.11. Vëllimi i prodhimit

Vëllimi i prodhimit në kuadër të projektit për zonën e eksploatimit të inerteve përcaktohet në përputhje me kapacitetin e planifikuar të nxjerrjes sipas planit të nxjerrjes dhe me organizimin e punës në terren. Kapaciteti real i nxjerrjes varet nga dinamika e operimit, numri i ditëve të punës gjatë vitit, kushtet klimatike, si dhe nga kërkesa e tregut për material të inerteve, ku vëllimi I paraparë është 30,000 m³ në vit. Vëllimi i prodhimit do të zhvillohet brenda kufijve të lejuar me leje nga KPMM dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe mjedisore në fuqi.

5.12. Kontrolli i ndotjes

Kontrolli i ndotjes gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit realizohet përmes masave të integruara për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe shëndetin publik. Aktivitetet si gërmimi, ngarkimi, transporti dhe lëvizja e makinerive mund të shkaktojnë pluhur, emetime dhe zhurmë, prandaj sipërfaqet e punës dhe rrugët e brendshme spërkaten rregullisht për të reduktuar ngritjen e grimcave. Ndërsa makineritë i nënshtrohen mirëmbajtjes së rregullt dhe përdoren karburante cilësore për të minimizuar emetimet e gazrave. Shpejtësia e mjeteve kufizohet dhe përdoren teknika për uljen e zhurmës gjatë ngarkimit dhe transportit. Gjatë gjithë periudhës së punimeve realizohet monitorim i vazhdueshëm i pluhurit, zhurmës dhe ujërave për të siguruar respektimin e standardeve mjedisore. Për të ruajtur florën dhe faunën, shtresa vegjetative e tokës ruhet dhe zonat e hapura kufizohen, duke zvogëluar ndikimin ekologjik dhe duke garantuar që aktivitetet e nxjerrjes të kryhen në mënyrë të kontrolluar dhe në përputhje me ligjin dhe standardet mjedisore..

5.13. Trajtimin e mbeturinave, përfshirë riciklimin, ripërdorimin, asgjësimin dhe deponimin përfundimtar

Në kuadër të projektit për eksploatimin e inerteve nuk parashihet trajtim apo përpunim i mbeturinave industriale në lokacion, pasi aktiviteti përfshin vetëm nxjerrje dhe transportin e materialit.

5.14. Rregulimi i infrastrukturës rrugore të qasjes në projekt dhe rrugë të komunikacionit

Rrugët e brendshme të zonës së eksploatimit janë të përcaktuara dhe të shtruara sipas nevojës për lëvizjen e makinerive dhe kamionëve transportues. Ato mbahen të rregulluara dhe të spërkatura gjatë periudhave të thata për të minimizuar pluhurin dhe për të siguruar qarkullim të sigurt. Përveç rrugëve brenda parcelës, hyrjet dhe daljet e kontrolluara lidhen me rrjetin rrugor ekzistues, duke garantuar një qarkullim të vazhdueshëm dhe të sigurt të mjeteve transportuese.

Projekti nuk kërkon ndërhyrje të mëdha infrastrukturore jashtë perimetrit të parcelës minerare, pasi shfrytëzohet infrastruktura ekzistuese rrugore dhe organizimi aktual i qasjes.

5.15. Përgjegjësia dhe procedurat për menaxhimin e mjedisit

Kompania “Gashi” Sh.p.k. është përgjegjëse për zbatimin e masave të mbrojtjes mjedisore dhe për sigurimin që aktivitetet e nxjerrjes të zhvillohen në përputhje me ligjin dhe standardet mjedisore.

Procedurat përfshijnë monitorimin e vazhdueshëm të ajrit, ujit dhe tokës, kontrollin e pluhurit, emetimeve dhe zhurmës, si dhe ruajtjen e florës dhe faunës në zonën e punimeve. Çdo punonjës dhe operator makinerie është i detyruar të respektojë udhëzimet operative, të përdorë pajisjet mbrojtëse dhe të raportojë menjëherë çdo incident ose devijim nga standardet.

Menaxhimi i mjedisit përfshin gjithashtu procedurat për rehabilitimin e sipërfaqeve të punës pas përfundimit të nxjerrjes, trajtimin e mbetjeve inerte dhe mbikëqyrjen e zbatimit të masave parandaluese për ndotje. Kompania duhet të mbajë regjistra të detajuar të monitorimeve dhe të raporteve, duke siguruar transparencë dhe mundësi verifikimi nga autoritetet mjedisore.

5.16. Trajnimi

Personeli do të trajnohet për përdorimin e pajisjeve, sigurinë në punë dhe mbrojtjen e mjedisit, për të siguruar një operim të sigurt dhe të qëndrueshëm.

5.17. Monitorimi

Do të kryhet monitorimi i rregullt të parametrave mjedisorë, në përputhje me kërkesat ligjore, për të siguruar që ndikimet negative të jenë të kontrolluara.

5.18. Planet për situata emergjente

Plani për situata emergjente do të përfshijë procedura të detajuara për reagimin ndaj incidenteve të mundshme, si zjarri, aksidentet e punës, apo ndalimet e papritura të pajisjeve. Ky plan do të sigurojë që personeli të jetë i trajnuar për të vepruar shpejt dhe në mënyrë të koordinuar në raste urgjente, për të minimizuar rrezikun dhe pasojat për sigurinë e punëtorëve dhe mjedisin.

5.19. Demolimi dhe rehabilitimi

Pas përfundimit të aktivitetit të nxjerrjes së inerteve, do të realizohet procesi i demolimit të çdo infrastrukture dhe objekteve të përkohshme të ndërtuara për mbështetje të operimeve. Ky proces do të përfshijë heqjen e makinerive të vjetra dhe ndarjen e materialeve të përdorura për ndërtim, duke i trajtuar ato sipas standardeve mjedisore. Gjithashtu, do të bëhet rikuperimi i terrenit të eksploatuar, duke restauruar vegjetacionin dhe stabilizuar sipërfaqet për të parandaluar erozionin e mundshëm dhe ndikimet mjedisore. Në këtë fazë, do të aplikohet një plan rehabilitimi që synon rikthimin e ekosistemit në një gjendje sa më të afërt me atë para fillimit të operimeve, përfshirë sistemimin e rrugëve të brendshme dhe menaxhimin e ujërave të shtratit dhe sipërfaqësorë.

5.20. Plani për menaxhimin e mjedisit

Plani për menaxhimin e mjedisit do të përfshijë masa të plota për parandalimin, monitorimin dhe korrigjimin e ndikimeve negative gjatë të gjitha fazave të projektit. Ky plan do të sigurojë që aktivitetet e nxjerrjes së materialit të zhvillohen në përputhje me ligjet dhe rregulloret mjedisore, duke minimizuar ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, dhe duke mbrojtur biodiversitetin dhe shëndetin e komunitetit lokal.

5.21. Përshkrimi i alternativës pa veprim

Alternativa pa veprim, e cila përfshin mosrealizimin e projektit të eksploatimit të materialeve inerte. Në këtë rast, nuk do të kryhet nxjerrja e rërës, zhavorrit dhe gurit, dhe asnjë ndërhyrje në terren nuk do të ndodhë.

Si pasojë: territori do të mbetet në gjendjen e tij natyrore, nuk do të krijohen ndikime mjedisore nga zhurma, pluhuri, transporti ose lëvizja e makinerive, dhe nuk do të ketë ndikim negativ mbi florën, faunën apo komunitetin përreth. Megjithatë, kjo alternativë nuk lejon shfrytëzimin e resurseve të depozitave inerte, duke kufizuar mundësinë e furnizimit për ndërtim dhe infrastrukturë, dhe nuk sjell përfitime ekonomike për investitorin apo komunitetin.

6. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS

6.1. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përfshinë

Identifikimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis përfshin analizimin e efektëve që mund të shkaktojë zona e eksploatimit të materialeve inerte gjatë fazës së operimit. Vlerësimi është bazuar në dokumentacionin teknik të projektit, karakteristikat natyrore të zonës dhe gjendjen ekzistuese mjedisore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ndikimet janë analizuar në tre aspekte kryesore:

- **Aspektet fizike**, që përfshijnë ndikimet në ajër nga pluhuri gjatë nxjerrjes dhe transportit, zhurmën dhe vibrimet, si dhe ndryshimet në reliev dhe përdorimin e burimeve natyrore;
- **Aspektet biologjike**, që lidhen me ndikimet e mundshme mbi vegjetacionin dhe mjedisin përreth brenda zonës së eksploatimit;
- **Aspektet socio-ekonomike**, që përfshijnë ndikimet mbi komunitetin lokal, punësimin dhe zhvillimin ekonomik.

Duke qenë se projekti përfshin vetëm nxjerrjen dhe transportin e materialeve, pa përpunim industrial dhe pa përdorim uji në procesin teknologjik, ndikimet mjedisore vlerësohen si lokale dhe të menaxhueshme. Faktorët kryesorë që mund të ndikojnë janë pluhuri, zhurma dhe ndryshimi i terrenit, të cilët do të kontrollohen përmes masave teknike dhe organizative të parashikuara në këtë raport. Qëllimi i vlerësimit është që aktiviteti të zhvillohet në mënyrë të kontrolluar, duke respektuar kërkesat ligjore dhe duke mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

6.2. Cilësinë e ajrit

Seksioni 6.2 përshkruan ndikimet në cilësinë e ajrit si rezultat i nxjerrjes dhe transportit të materialeve inerte. Gjatë operimit, aktivitetet kryesore që prodhojnë ndotje të ajrit janë gërmimi, ngarkimi dhe lëvizja e makinerive dhe kamionëve në rrugët e brendshme të zonës së punimeve. Këto aktivitete shkaktojnë ngritje pluhuri dhe emetime nga motorët e pajisjeve (CO₂, NO_x, SO₂), të cilat mund të ndotin ajrin përreth, kryesisht në afërsi të frontit të punës..

6.3. Niveli dhe përqendrimin e substancave ndotëse në ajër dhe krahasimin me treguesit e përcaktuar me norma dhe standardet sipas legjislacionit në fuqi

Gjatë operimit, burime kryesore të ndotjes janë pluhuri i ngritur nga gërmimi dhe lëvizja e materialeve, si dhe emetimet nga motorët e makinerive (CO₂, NO_x, SO₂ dhe grimca të imëta). Masat teknike dhe organizative që aplikohen – si spërkatja e rrugëve dhe sipërfaqeve të punës,

kufizimi i shpejtësisë së kamionëve dhe mirëmbajtja e makinerive – reduktojnë përqendrimin e këtyre substancave në ajër.

Vlerësimet tregojnë që nivelet e substancave ndotëse mbeten nën kufijtë e lejuar sipas legjislacionit në fuqi, duke e bërë ndikimin të kontrollueshëm dhe të përkohshëm. Kjo siguron që cilësia e ajrit për komunitetin dhe ekosistemet përreth të ruhet brenda parametrave të pranueshëm, sipas standardeve mjedisore dhe ligjore të Kosovës.

6.4. Ndikimin e projektit në klimë, lloji dhe vëllimi i emetimeve të gazeve serrë dhe ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike

Ndikimi i projektit në klimë lidhet kryesisht me emetimet e gazeve serrë që prodhohen nga makineritë dhe transporti i materialeve inerte. Burimet kryesore janë motorët e ekskavatorëve, ngarkuesve dhe kamionëve, të cilët lëshojnë kryesisht CO₂, NO_x dhe SO₂ në ajër. Vëllimi i këtyre emetimeve është i kufizuar dhe i përkohshëm, pasi aktiviteti është i lokalizuar dhe fokusohet vetëm në nxjerrjen dhe transportin pa përpunim industrial ose përdorim të energjisë shtesë.

Ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike është e ulët. Projekti nuk kërkon përdorim të ujit për procese teknologjike, nuk ka struktura të ndjeshme ndaj motit ekstrem dhe nuk ndikon në mënyrë të konsiderueshme mbi mikroklimën lokale. Masat operative, si kufizimi i shpejtësisë së mjeteve dhe spërkatja e rrugëve, ndihmojnë gjithashtu në reduktimin e pluhurit dhe ndikimeve të mundshme klimatike.

Në përgjithësi, projekti ka një ndikim minimal në klimë dhe nuk konsiderohet i ndjeshëm ndaj ndryshimeve klimatike të pritura, duke qenë i menaxhueshëm brenda parametrave të standardeve ligjore dhe mjedisore.

6.5. Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit

Bazuar në natyrën, madhësinë dhe shtrirjen e kufizuar të projektit, nuk pritet që aktiviteti i zonës së eksploatimit të inerteve të shkaktojë ndotje ndërkufitare të ajrit. Emetimet në ajër nga projekti janë të karakterit lokal dhe lidhen kryesisht me pluhurin dhe gazrat nga makineritë dhe kamionët brenda perimetrit të zonës së eksploatimit.

6.6. Cilësia e ujit

Duke qenë se në lokacion nuk zhvillohet thërrmim, larje apo përpunim tjetër i materialit, rreziku për ndotje të ujërave nga vetë procesi i operimit vlerësohet si i ulët. Ndikimet e mundshme mund të lidhen vetëm me raste aksidentale, si rrjedhje të karburanteve ose vajrave nga makineritë, të cilat mund të menaxhohen përmes masave parandaluese dhe kontrollit teknik të pajisjeve.

6.7. Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Bazuar në natyrën e projektit, nuk pritet ndikim në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, pasi aktiviteti nuk përfshin shkarkime të ujërave të ndotura, nuk përdor ujë për proces pune dhe nuk krijon ujëra të zeza teknologjike. Ndotësit potencialë që teorikisht mund të ndikojnë në ujë janë të lidhur vetëm me situata të paparashikuara, si rrjedhje të naftës, vajrave lubrifikues ose materialeve të tjera nga makineritë operative. Këto ndikime do të ishin lokale dhe të kufizuara, ndërsa mundësia për depërtim në ujëra nëntokësore mbetet e ulët nëse respektohen masat për mirëmbajtje teknike, parkim të kontrolluar të makinerive dhe reagim të menjëhershëm në rast aksidenti. Për këtë arsye, ndikimi i projektit në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore vlerësohet si i ulët dhe i menaxhueshëm.

6.8. Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkuftare të ujërave

Duke marrë parasysh shkallën e projektit, natyrën lokale të aktivitetit dhe mungesën e shkarkimeve ujore nga procesi i punës, nuk pritet që projekti të ketë ndikim në ndotjen ndërkuftare të ujërave.

6.9. Ndryshimet hidromorfologjike, sasia dhe cilësia me referencë të veçantë për shkarkimet e ujërave të zeza

Projekti nuk parashihet të shkarkojë ndryshime hidromorfologjike të trupave ujorë, pasi aktiviteti i ekspluatimit zhvillohet në një zonë të kufizuar tokësore dhe nuk përfshin ndërhyrje në shtretër lumenjsh, përroje, kanale apo trupa të tjerë ujorë. Po ashtu, projekti nuk përfshin përdorim të ujit në proces, nuk gjeneron ujëra teknologjike dhe nuk parashikon shkarkime të ujërave të zeza industriale. Sa i përket ujërave të zeza sanitare, duke qenë se aktiviteti realizohet nga personel i angazhuar në baza ditore dhe nuk parashihet ndërtimi i kampeve apo rezidencave, ndikimi nga kjo kategori mbetet minimal dhe i menaxhueshëm përmes organizimit të përshtatshëm sanitar sipas kushteve të operimit. Për rrjedhojë, nuk priten ndryshime në sasinë apo cilësinë e ujërave si rezultat i projektit.

6.10. Toka

Ndikimet në tokë për zonën e ekspluatimit të inerteve, ndikimet janë të lidhura kryesisht me ndërhyrjet fizike që ndodhin gjatë nxjerrjes dhe ndryshimin e relievit të zonës. Gjatë punëve përgatitore dhe hapjes së fronteve të reja të nxjerrjes, mund të ndodhin largime të shtresës sipërfaqësore dhe kompaktim i tokës për shkak të kalimit të makinerive të rënda. Këto ndërhyrje krijojnë skarpa dhe ndryshojnë formën natyrore të terrenit brenda kufijve të parcelës minerare. Një rrezik tjetër mund të jetë ndotja aksidentale e tokës nga rrjedhja e karburanti ose vajrash nga makineritë dhe kamionët. Ky rrezik është i kufizuar, por kërkon kontrolle dhe

mirëmbajtje të rregullt të pajisjeve. Pas përfundimit të aktivitetit, parashihet rehabilitimi i zonës për stabilizimin e terrenit dhe rikthimin gradual të sipërfaqes në gjendje natyrore

6.11. Ndikimi fizik, ndryshimi në topografinë lokale, erozioni i tokës, rrëshqitjet e tokës, etj.

Zona e eksploatimit do të shkaktojë ndryshim fizik të sipërfaqes dhe të topografisë lokale, si rezultat i nxjerrjes së masës shkëmbore dhe formimit progresiv të fronteve të punës. Ndryshimet në relief janë të pritshme dhe përbëjnë një karakteristikë tipike të aktiviteteve të nxjerrjes sipërfaqësore. Gjithashtu, heqja e shtresës humusore dhe ekspozimi i terrenit mund të rrisin ndjeshmërinë ndaj erozionit, sidomos gjatë reshjeve intensive. Rreziku për rrëshqitje të tokës vlerësohet i kufizuar, por kërkon respektim të parametrave teknikë për stabilitetin e skarpave dhe organizimin e duhur të fazave të procesit mekanik. Me zbatimin e masave teknike për stabilizimin e terrenit, menaxhimin e ujërave atmosferike dhe rehabilitimin progresiv, këto ndikime mbeten të kontrollueshme dhe të menaxhueshme.

6.12. Ndikimi i emetimeve të ndotësve në vendndodhjen e projektit të planifikuar dhe në tokën përreth dhe krahasimin me treguesit e përcaktuar me norma dhe standarde sipas legjislacionit përkatës

Ndikimet e mundshme në tokë nga emetimet ndotëse lidhen kryesisht me depozitimin e pluhurit të krijuar gjatë nxjerrjes, ngarkimit dhe transportit të materialit, si dhe me mundësinë e rrjedhjeve aksidentale të karburanteve ose vajrave nga makineritë operative. Depozitimi i pluhurit mund të ndikojë në sipërfaqen e tokës brenda dhe pranë zonës së eksploatimit, por për shkak të karakterit lokal të aktivitetit dhe mungesës së procesit industrial në lokacion, ky ndikim pritet të mbetet i kufizuar. Ndikimi në tokën përreth do të jetë më i ulët me rritjen e distancës nga fronti i punës. Në rast se makineritë mirëmbahen rregullisht dhe zbatohen masa parandaluese për shmangien e rrjedhjeve, ndikimi në cilësinë e tokës vlerësohet i ulët dhe brenda niveleve të menaxhueshme sipas kërkesave të legjislacionit mjedisor në fuqi.

6.13. Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore

Zona e eksploatimit përdoret kryesisht për nxjerrjen e materialeve inerte dhe nuk përfshin përpunim industrial, prandaj ndikimi është i lokalizuar.

Nxjerrja e rërës, zhavorrit dhe gurit ndryshon përdorimin e tokës gjatë operimit, duke krijuar sipërfaqe të hapura dhe korridore pune për makineritë. Burimet natyrore të tokës dhe shtresa vegjetative ruhen pjesërisht për rehabilitimin pas përfundimit të punimeve. Erozioni i tokës dhe ndryshimet në relief mund të ndodhin në mënyrë të përkohshme, por zbatimi i masave të

kontrollit si drenazhi, spërkatja e sipërfaqeve dhe rikthimi i shtresës bimore e minimizon këtë ndikim.

Për sa i përket burimeve të tjera natyrore, projekti nuk kërkon përdorim të ujit për procese teknologjike dhe nuk ndikon në habitatet përreth përtej zonës operative. Në përgjithësi, ndikimi mbi shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore vlerësohet si i menaxhueshëm dhe i përkohshëm, duke lejuar rehabilitimin e zonës dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së ekosistemit.

6.14. Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur

Shtresa humusore është e cekët dhe në pjesët e eksploatimit paraqitet kryesisht terren gurore. Shtresa e sipërme e tokës që largohet gjatë punëve përgatitore do të ruhet për t'u përdorur më vonë në rehabilitimin dhe rikultivimin e sipërfaqes së shfrytëzuar. Kjo sipërfaqe e cila do të shfrytëzohet është 0.6749 ha.

6.15. Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike

Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike është i drejtpërdrejtë, pasi aktiviteti përfshin nxjerrjen e masës shkëmbore të inerteve dhe ndryshimin e konfiguracionit të terrenit në zonën e eksploatimit. Nga aspekti gjeologjik, projekti ndërhyr në formacionet e inerteve që përbëjnë burimin e zonës, ndërsa nga aspekti gjeomorfologjik ai sjell modifikim të relievit lokal përmes krijimit të fronteve të nxjerrjes dhe ndryshimit të pjerrësive ekzistuese. Këto ndikime janë të natyrshme për këtë kategori projektesh dhe mbeten të kufizuara brenda sipërfaqes së miratuar të eksploatimit. Me përfundimin e aktivitetit, rehabilitimi i terrenit do të kontribuojë në stabilizimin e sipërfaqes dhe në zvogëlimin gradual të efektit morfologjik të ndërhyrjes minerare.

6.16. Popullsia lokale

Zona ndodhet larg vendbanimeve më të afërta rreth 42 metra, prandaj efektet mbi komunitetin janë kryesisht të përkohshme dhe të kufizuara. Aktiviteti i projektit nuk përfshin procese industriale të përpunimit në lokacion dhe zhvillohet brenda një zone tashmë të dedikuar për eksploatim, çka bën që ndikimet mbi komunitetin lokal të jenë të kufizuara kryesisht në aspektin e perceptimit vizual, qarkullimit të kamionëve dhe ndikimeve të përkohshme nga pluhuri, zhurma dhe vibrimet. Në anën tjetër, projekti ka edhe efekte pozitive në nivel lokal përmes vazhdimësisë së aktivitetit ekonomik dhe angazhimit të fuqisë punëtore.

6.17. Ndryshimet në numrin dhe strukturën e popullsisë dhe ndikimet të lidhura me mjedisin, popullsinë, përqendrimi dhe migrimi

Duke qenë se projekti paraqet zonë të eksploatimit dhe nuk përfshin ndërtim të kampeve, rezidencave apo vendosje të përhershme të punëtorëve në lokacion, nuk priten ndryshime të rëndësishme në numrin dhe strukturën e popullsisë lokale. Projekti nuk krijon përqendrim të ri të popullsisë dhe nuk pritet të ndikojë në lëvizjet migratore të zonës. Ndikimet që lidhen me popullsinë mbeten të kufizuara dhe lidhen kryesisht me aktivitetin e përditshëm të operimit, pa pasoja të ndjeshme demografike apo sociale në vendbanimet përreth.

6.18. Ndikimet vizuale të vendbanimeve

Zona e projektit për shfrytëzimin e materialeve inerte ndodhet në parcelën nr. 05611-0, në zonën kadastrale Pejë, me shtepi të shpërndara në distancë minimale prej 420 metrash nga zona e eksploatimit. Për shkak të kësaj distance dhe të organizimit të kontrolluar të punimeve, ndikimet vizuale mbi vendbanimet e afërta konsiderohen të kufizuara.

Gjatë nxjerrjes së materialeve, aktivitetet kryesore që mund të ndikojnë vizualisht përfshijnë germimet nga nxjerrja e inerteve, prezencën e makinerive të rënda, materialeve të grumbulluara dhe lëvizjen e kamionëve brenda parcelës

6.19. Ndikimet e emetimit të ndotësve, zhurmës, vibrimet, nxehtësisë dhe të gjitha llojet e rrezatimit në shëndetin e njeriut

Ndikimet potenciale në shëndetin e njeriut lidhen kryesisht me pluhurin, zhurmën dhe vibrimet që krijohen gjatë nxjerrjes, ngarkimit dhe transportit të materialit. Këto ndikime janë më të theksuara për punëtorët e angazhuar drejtpërdrejt në operim, të cilët mund të ekspozohen ndaj niveleve të rritura të pluhurit dhe zhurmës nëse nuk zbatohen masat përkatëse mbrojtëse. Për popullsinë përreth, rreziku për ndikim në shëndet vlerësohet i ulët, për shkak të largësisë së lokacionit nga vendbanimet. Projekti nuk përfshin procese që gjenerojnë nxehtësi industriale apo rrezatim të dëmshëm, prandaj nuk priten ndikime nga këta faktorë. Me përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale, organizimin e sigurt të punës dhe mirëmbajtjen teknike të makinerive, rreziqet për shëndetin e njeriut mund të mbahen nën kontroll.

6.20. Ndikimet socio-ekonomike

Zbatimi i projektit për shfrytëzimin e materialeve inerte në parcelën nr. 05611-0 ka ndikime të konsiderueshme socio-ekonomike për komunitetin lokal dhe rajonin përreth. Nga njëra anë, projekti krijon mundësi për punësim të përkohshëm dhe afatgjatë, sidomos për banorët lokalë, duke përfshirë operimin e makinerive, transportin e materialeve dhe menaxhimin e zonës operative. Ky aktivitet kontribuon në rritjen e të ardhurave për individët dhe ekonominë lokale.

Projektet e nxjerrjes së materialeve inerte gjithashtu mund të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të rajonit përmes furnizimit me materiale ndërtimi, lehtësimit të infrastrukturës dhe përmirësimit të kapaciteteve lokale të ndërtimit. Për më tepër, projekti mund të mbështesë zhvillime të tjera industriale ose tregtare në zonë, duke rritur aktivitetin ekonomik dhe duke përmirësuar ofertën e shërbimeve për komunitetin.

Ndikimet socio-ekonomike janë kryesisht pozitive, duke krijuar punësim dhe zhvillim ekonomik, ndërkohë që masat mbrojtëse sigurojnë që shqetësimet për komunitetin dhe mjedisin të jenë minimale

6.21. Ndikimi i projektit në strukturën e ekonomisë lokale, sipas sektorit prodhues dhe degës kryesore të zonës

Projekti ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë mbi ekonominë lokale. Zona karakterizohet kryesisht nga aktivitet industrial. Projekti siguron furnizim të qëndrueshëm me rërë dhe zhavorr, duke forcuar sektorin prodhues lokal, krijuar mundësi punësimi dhe stimuluar aktivitete të tjera industriale dhe tregtare. Masat mbrojtëse dhe menaxhimi i kontrolluar i operimeve minimizojnë ndikimet negative sociale dhe mjedisore, duke siguruar përfitime ekonomike të qëndrueshme për komunitetin lokal.

6.22. Numri i vendeve të punës të krijuara gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit të projektit, si dhe humbjet e mundshme të vendeve të punës në sektorët apo zonat e prekura

Projekti për shfrytëzimin e materialeve inerte pritet të krijojë vende të punës gjatë të gjithë ciklit të tij. Gjatë fazës së ndërtimit dhe organizimit të zonës operative, do të ketë mundësi për punësim të përkohshëm, kryesisht për operimin e makinerive, transportin e materialeve, ndërtimin e rrugëve dhe platformave operative, si dhe menaxhimin dhe monitorimin e punimeve.

Gjatë fazës së funksionimit, projekti do të sigurojë vende të punës afatgjata për personelin operativ, teknik dhe administrativ, duke përfshirë kontrollin e cilësisë së materialeve dhe menaxhimin e masave mjedisore dhe të sigurisë.

Nuk priten humbje të vendeve të punës në sektorët ekzistues apo në zonat përreth, pasi aktiviteti është planifikuar të zhvillohet në hapësira industriale të dedikuara dhe nuk shkakton ndërprerje të funksioneve ekzistuese të kompanive ose banesave lokale. Për më tepër, projekti mund të ketë efekt pozitiv në ekonominë lokale duke ofruar punësim dhe stimuluar aktivitete të tjera industriale dhe tregtare.

6.23. Kontributi i projektit në ekonominë rajonale dhe kombëtare

Projekti për shfrytëzimin e materialeve inerte ka një kontribut të rëndësishëm ekonomik në nivel rajonal dhe kombëtar. Ai siguron furnizim të qëndrueshëm me materiale ndërtimi, të tilla si rëra dhe zhavorrit duke mbështetur zhvillimin e infrastrukturës lokale dhe rajonale.

Në nivel rajonal, projekti krijon mundësi punësimi për banorët lokalë gjatë fazave të ndërtimit dhe operimit, stimulohet aktiviteti ekonomik në sektorin e ndërtimit dhe transportit, dhe rritet qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve të lidhura me këtë sektor.

Në nivel kombëtar, materiali i nxjerrë mund të përdoret në projekte ndërtimore dhe infrastrukture në zonat përreth, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit dhe në stabilitetin e sektorit të ndërtimit. Projekti gjithashtu mund të ndikojë në rritjen e të ardhurave nga tatimet dhe kontributet sociale, duke përmirësuar situatën ekonomike të rajonit dhe shtetit.

6.24. Ekosistemet dhe gjeologjia

Zona e projektit për shfrytëzimin e materialeve inerte është kryesisht e rrafshët dhe e hapur, me lumin Lumbardhi të Pejës në afërsi (rreth 270 m). Ekosistemet në këtë parcelë janë të përfaqësuara nga hapësira me bimësi të ulët dhe pak pyje të shpërndara, ndërsa fauna përbëhet kryesisht nga speciet e zakonshme lokale të zonave të hapura. Flora dhe fauna e parcelës është relativisht e thjeshtë, pa prezencë të specieve endemike ose të rralla.

Struktura gjeologjike e parcelës përbëhet nga depozita inerte të natyrshme, përfshirë rërë dhe zhavorr. Shtresat janë të qëndrueshme dhe nuk paraqesin rrezik për operimet e nxjerrjes. Terreni i rrafshët mundëson qasje të lehtë për makineritë dhe organizimin e punimeve, ndërsa pranë lumit janë parashikuar masa për kontrollin e erozionit dhe menaxhimin e ujërave sipërfaqësorë.

6.25. Humbja dhe dëmtimi i specieve bimore dhe shtazore dhe habitateve të tyre

Zona e projektit është kryesisht e rrafshët, me bimësi të ulët dhe pak pyje të shpërndara, ndërsa fauna përbëhet kryesisht nga speciet lokale të zakonshme të zonave të hapura. Prania e lumit Lumbardhi në afërsi ofron habitat për speciet ujëtokësore dhe disa shpendë të zakonshëm.

Gjatë realizimit të projektit, ndarja dhe zhvendosja e materialeve mund të shkaktojë humbje të pjesshme të bimëve të ulëta dhe ndërhyrje në habitatet e specieve të zakonshme. Megjithatë, nuk priten humbje të specieve endemike, relikte ose të rrezikuara, pasi zona nuk përmban pyje të dendura ose habitate të veçanta të mbrojtura.

6.26. Humbja dhe dëmtimi i veçorive gjeologjike, paleontologjike dhe gjeomorfologjike, biodiversitetit, florës dhe faunës, pasurive natyrore të mbrojtura, specieve të rralla dhe të rrezikuara të bimëve dhe kafshëve të egra dhe habitateve të tyre

Zona e projektit përbëhet nga depozita inerte natyrore, përfshirë rërë dhe zhavorr, pa praninë e veçorive gjeologjike, paleontologjike ose gjeomorfologjike të rrezikuara.

Biodiversiteti në zonë përfaqësohet nga bimësi e zakonshme dhe disa pyje të shpërndara, ndërsa fauna përfshin speciet lokale të zakonshme të zonave të hapura. Lumi Lumbardhi i Pejës në afërsi ofron habitat për speciet ujëtokësorë dhe disa shpendë të zakonshëm. Nuk janë identifikuar speciet endemike, relikte ose të rrezikuara brenda zonës, dhe nuk përfshihen pasuri natyrore të mbrojtura.

Ndikimet e mundshme përfshijnë dëmtimin e bimëve të ulëta, ndërhyrje të pjesshme në habitatet e specieve të zakonshme dhe ndryshime të strukturës sipërfaqësore të tokës gjatë nxjerrjes së materialeve.

6.27. Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve

Qëllimi i projektit është shfrytëzimi i materialeve inerte për ndërtim dhe infrastruktura, duke përdorur sipërfaqet e parcelës në mënyrë të organizuar dhe të kontrolluar. Shfrytëzimi i sipërfaqeve është i organizuar në mënyrë që të sigurohet efikasiteti operativ, të minimizohen ndikimet mjedisore dhe sociale, dhe të ruhet integriteti i zonës. Çdo pjesë e sipërfaqes ka funksion të përcaktuar dhe përdoret vetëm për aktivitetet e planifikuara, duke garantuar që operimi të jetë i qëndrueshëm dhe i kontrolluar.

6.28. Sipërfaqet e ndërtuara dhe të pa ndërtuara

Zona e projektit për shfrytëzimin e materialeve inerte përbëhet nga sipërfaqe të ndërtuara dhe të pa ndërtuara. Sipërfaqet e ndërtuara përfshijnë platot dhe rrugët operative brenda parcelës, zonat e grumbullimit dhe klasifikimit të materialeve, si dhe hapësirat për makineritë dhe pajisjet operative, të planifikuara për të lehtësuar menaxhimin e punimeve dhe minimizuar ndikimet mjedisore. Sipërfaqet e pa ndërtuara përfaqësojnë hapësirat natyrore dhe ato të përdorura për rehabilitim pas përfundimit të operimeve, përfshirë pjesët me bimësi të ulët, menaxhimin e ujërave sipërfaqësore, kontrollin e pluhurit dhe rikthimin e habitatit natyror, duke mbajtur ekuilibrin ekologjik të zonës..

6.29. Shfrytëzimi i tokës

Toka në zonën e projektit shfrytëzohet për nxjerrjen dhe transportin e materialeve inerte, duke siguruar qasje të kontrolluar për makineritë dhe transportin. Sipërfaqet që nuk përdoren

drejtpërdrejt për nxjerrjen shfrytëzohen për rrugët e brendshme dhe për vendosjen e makinerive operuese, duke organizuar hapësirën në mënyrë të efektshme dhe të sigurt. Shfrytëzimi i tokës është planifikuar në mënyrë të qartë, ku çdo zonë ka funksion të përcaktuar dhe përdoret vetëm për aktivitetet e projektit.

6.30. Infrastruktura komunale

Zona e projektit është e lidhur me infrastrukturën ekzistuese komunale, duke përfshirë rrjetin rrugor, furnizimin me ujë dhe energji elektrike. Rruga tranzit që kalon pranë parcelës (rreth 200 m) dhe rruga regjionale Pejë–Klinë (rreth 1 km) sigurojnë qasje të lehtë dhe të sigurt për transportin e materialeve inerte dhe makinerive. Brenda zonës operative janë planifikuar rrugët e brendshme për qarkullim të kontrolluar të mjeteve dhe vendosjen e makinerive, duke respektuar kufijtë e parcelës dhe distancat nga banesat e afërta.

6.31. Trafiku

Zbatimi i projektit për shfrytëzimin e materialeve inerte do të ndikojë në trafikun në zonën përreth parcelës, kryesisht për shkak të lëvizjes së mjeteve të rënda për nxjerrje dhe transport të materialeve. Rruga tranzit që kalon pranë parcelës (rreth 200 m larg) dhe rruga regjionale Pejë–Klinë (rreth 1 km) ofrojnë qasje të sigurt dhe të menaxhueshme për transportin, duke shmangur rrugët lokale dhe banesat e afërta.

6.32. Furnizimi me ujë

Furnizimi me ujë për nevojat e projektit do të realizohet përmes rrjetit ekzistues të ujësjellësit rajonal të Komunës së Pejës. Uji nuk do të përdoret për përpunimin ose larjen e materialit, por vetëm për kontrollin e pluhurit.

Gjatë periudhave të thata, rrugët e brendshme, zonat e ngarkimit dhe sipërfaqet operative do të spërkatën së paku dy herë në ditë, para fillimit të punës dhe gjatë orëve të pasdites. Në periudhat me temperatura të larta, erë të fortë ose qarkullim të shtuar të automjeteve, spërkatja do të bëhet më shpesh, varësisht nga gjendja e terrenit dhe niveli i krijimit të pluhurit.

Spërkatja do të organizohet nga kompania. Në kushte normale, uji do të merret nga rrjeti i ujësjellësit rajonal, ndërsa në rast të mungesës ose kufizimeve të furnizimit me ujë gjatë sezonit veror, kompania do të sigurojë ujë përmes autocisternave.

6.33. Energjia

Projekti nuk kërkon furnizim me energji elektrike për procese prodhuese, pasi në lokacion nuk realizohet thërrmim apo trajtim i materialit.

6.34. Ujërat e zeza

Projekti nuk gjeneron ujëra të zeza teknologjike apo industriale, pasi aktiviteti nuk përfshin procese përpunimi dhe nuk përdor ujë në proces pune.

6.35. Gjenerimi i mbeturinave

Gjatë operimit të projektit nuk gjenerohen mbeturina industriale apo mbetje nga përpunimi, pasi në lokacion zhvillohet vetëm nxjerrje dhe transporti i materialit inert. Mbeturinat kryesore që krijohen janë mbeturinat komunale të gjeneruara nga personeli gjatë qëndrimit në vendpunishte, si ambalazhe ushqimore, shishe plastike dhe mbetje të tjera të zakonshme. Sasia e tyre është e vogël dhe lidhet drejtpërdrejt me numrin e punëtorëve dhe kohëzgjatjen e operimit. Këto mbeturina do të grumbullohen në mënyrë të kontrolluar dhe do të largohen përmes sistemit komunal ose operatorit të kontraktuar për menaxhimin e mbeturinave.

6.36. Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe rrethina e tyre, veçoritë e peizazhit

Zona e projektit nuk përfshin pasuri natyrore apo kulturore të mbrojtura brenda parcelës. Veçoritë e peizazhit lidhen kryesisht me hapësirat e hapura dhe lumin Lumbardhi në afërsi, i cili kontribuon në peizazhin lokal dhe ofron habitat për flora dhe fauna të zakonshme të zonës. Përreth parcelës ndodhen disa shtepi të shpërndara dhe aktivitete afariste, por nuk ka monumente historike, objekte kulturore të mbrojtura apo zona natyrore të klasifikuara si rezervate apo park natyror. Peizazhi lokal karakterizohet nga hapësira të gjera me bimësi të ulët dhe zona operative të ndarë qartë, që sigurojnë integrimin vizual të aktivitetit të projektit në mjedisin përreth.

6.37. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përmban gjithashtu informacione që rezultojnë

Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis për projektin e zonës së eksploatimit të inerteve, bazohet në natyrën e aktivitetit të planifikuar, në karakteristikat e lokacionit, në mënyrën e zhvillimit të procesit të nxjerrjes së materialeve inerte dhe transportit, si dhe në gjendjen ekzistuese të faktorëve mjedisorë në zonën e projektit. Vlerësimi është mbështetur në të dhënat për reliev, përbërjen gjeologjike, përdorimin aktual të sipërfaqes, distancën nga vendbanimet, mungesën e proceseve industriale në lokacion, si dhe në identifikimin e ndikimeve tipike që lidhen me aktivitete të nxjerrjes së inerteve, si pluhuri, zhurma, vibrimet dhe ndryshimi i topografisë. Në këtë kuadër janë marrë parasysh edhe masat e planifikuara për kontrollin e ndikimeve dhe rehabilitimin progresiv të sipërfaqes së shfrytëzuar.

6.38. Zbatimi i projektit, duke përfshirë punimet e largimit, sipas rastit

Zbatimi i projektit përfshin fillimisht punët përgatitore në terren, të cilat konsistojnë në pastrimin e sipërfaqes nga vegjetacioni dhe materialet e papërshtatshme, largimin dhe ruajtjen e shtresës humusore, sistemimin e terrenit dhe hapjen e rrugëve të brendshme për qarkullimin e makinerive dhe kamionëve. Në përfundim të operimeve ose në rast të largimit nga zona e eksploatimit, lokacioni duhet të rehabilitohet dhe të rikthehet në gjendjen e tij të mëparshme sa më afër të mundshme.

6.39. Ndikimet kumulative të projekteve të tjera ekzistuese

Analiza e ndikimeve kumulative merr parasysh efektet e projektit të propozuar në kombinim me projektet e tjera ekzistuese në zonë dhe rrethinat e saj. Në afërsi të parcelës operative ndodhen disa aktivitete industriale dhe afariste, përfshirë separacione dhe zona të ngjashme për nxjerrje dhe përpunim të materialeve inerte.

Ndikimet kumulative mund të shfaqen kryesisht te: pluhuri, zhurma, qarkullimi i mjeteve të rënda dhe presioni mbi infrastrukturën rrugore. Megjithatë, distanca e sigurisë nga vendbanimet më të afërta dhe organizimi i kontrolluar i punimeve zvogëlojnë efektet e mundshme mbi komunitetin dhe mjedisin lokal.

Kur merren parasysh të gjitha aktivitetet ekzistuese dhe projekti i propozuar, vlerësimi tregon se ndikimet kumulative mbeten të menaxhueshme dhe brenda kufijve të pranueshëm, për shkak të masave mbrojtëse, monitorimit të vazhdueshëm dhe përdorimit të infrastrukturës së planifikuar për qarkullimin dhe shfrytëzimin e zonës

6.40. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis

Shtrirja hapësinore e ndikimit negativ të projektit për shfrytëzimin e materialeve inerte është kryesisht e kufizuar brenda parcelës operative dhe zonave të afërta për rrugë dhe makineri. Ndikimet kryesore përfshijnë shpërndarjen e pluhurit gjatë nxjerrjes dhe transportit, zhurmën nga makineritë dhe kamionët, si dhe përdorimin e ujit për kontrollin e pluhurit.

Në afërsi të parcelës ndodhen disa shtepi të shpërndara, me distancë minimale prej 420 metrash, dhe lumi Lumbardhi, rreth 270 metra larg. Masat mbrojtëse të aplikuara përfshijnë qarkullimin e kontrolluar të mjeteve, spërkatjen e sipërfaqeve për minimizimin e pluhurit, vendosjen e makinerive brenda hapësirave të përcaktuara dhe rehabilitimin e sipërfaqeve pas përfundimit të punimeve.

Si rezultat, ndikimi negativ i projektit është i kufizuar kryesisht në zonën operative dhe në rrugët e qarkullimit brenda parcelës, ndërsa efektet mbi komunitetin lokal dhe mjedisin e afërt janë të menaxhueshme dhe të reduktuara nga masat mbrojtëse dhe monitorimi i vazhdueshëm.

6.41. Shkarkimi i ujërave të ndotura gjatë fazës së ndërtimit

Projekti nuk përfshin fazë ndërtimi dhe nuk pritet përdorimi i ujit.

6.42. Emetimet e rrezatimit elektromagnetik gjatë ndërtimit

Në kuadër të projektit nuk parashihen procese, pajisje apo instalime që gjenerojnë rrezatim elektromagnetik me ndikim të rëndësishëm mjedisor ose shëndetësor gjatë fazës së zbatimit.

6.43. Emetimet në ajër të gazeve serrë gjatë operimit

Gjatë operimit të projektit për shfrytëzimin e materialeve inerte, emetimet në ajër të gazeve serrë janë minimale dhe lidhen kryesisht me funksionimin e makinerive të rënda dhe transportin e materialeve. Lëvizja e kamionëve dhe makinerive me motorë me djegie të brendshme mund të prodhojë sasi të vogla të dioksidit të karbonit (CO₂), oksidit të azotit (NO_x) dhe monoksidit të karbonit (CO).

Aktivitetet operative nuk përfshijnë djegie të hapur ose procese industriale me emetime të konsiderueshme, dhe përdorimi i makinerive është i kufizuar brenda parcelës dhe rrugëve të planifikuara.

Si rezultat, ndikimi i gazeve serrë në ajër është i kufizuar, i menaxhueshëm dhe nuk pritet të ndikojë ndjeshëm në cilësinë e ajrit në zonën përreth ose në komunitetin lokal

6.44. Ndikimet në ndryshimet klimatike

Gjatë operimit të projektit për shfrytëzimin e materialeve inerte, ndikimet në ndryshimet klimatike lidhen kryesisht me emetimet e vogla të gazeve serrë nga makineritë dhe transporti i materialeve. Aktivitetet operative nuk përfshijnë djegie të hapur ose procese industriale me emetime të mëdha, dhe përdorimi i makinerive është i kufizuar brenda parcelës dhe rrugëve të planifikuara.

Masat mbrojtëse përfshijnë mirëmbajtjen e rregullt të makinerive, përdorimin e rrugëve dhe platformave operative të kontrolluara, dhe limitimin e lëvizjeve të panevojshme të mjeteve. Si rezultat, kontributi i projektit ndaj ndryshimeve klimatike është minimal dhe i menaxhueshëm, pa rrezik për përkeqësimin e gjendjes klimatike lokale apo rajonale. Projekti zhvillohet në përputhje me standardet mjedisore dhe praktikën e qëndrueshme për minimizimin e emetimeve.

7. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS

7.1.Masat e parashikuara me legjislacion

Për të parandaluar, reduktuar ose eliminuar ndikimet negative të projektit mbi mjedisin, kompania “Gashi” Sh.p.k. duhet ti zbatojë masat mbrojtëse në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, përfshirë Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe rregulloret komunale për ndërtim.

Masat përfshijnë: kontrollin e pluhurit dhe zhurmës gjatë operimeve, menaxhimin e ujërave sipërfaqësore dhe mbeturinave, mbrojtjen e florës dhe faunës së zonës, organizimin e punimeve brenda parcelës dhe rehabilitimin e sipërfaqeve pas përfundimit të operimeve. Të gjitha aktivitetet do të jenë në përputhje me standardet mjedisore, social-ekonomike dhe të sigurisë, duke garantuar që ndikimet negative mbi mjedisin dhe komunitetin të jenë të reduktuara dhe të menaxhueshme

7.2.Masat që duhen marrë në rast aksidentesh dhe fatkeqësive të mëdha

Për të minimizuar rreziqet ndaj personelit, komunitetit dhe mjedisit në rast aksidentesh ose fatkeqësish të mëdha, kompania “Gashi” Sh.p.k. ka parashikuar një plan emergjence dhe masa të detajuara mbrojtëse. Këto përfshijnë:

- Procedura të emergjencës: Aktivizimi i protokolleve të brendshme për evakuim të punonjësve dhe ndërprerje të menjëhershme të punimeve në rast incidentesh.
- Komunikimi dhe njoftimi: Njoftimi i autoriteteve lokale dhe institucionet përgjegjëse për mjedisin dhe emergjencat, duke përfshirë njësitë e zjarrfikësve dhe shërbimet mjekësore.
- Masat për kontrollin e rreziqeve: Sigurimi i hapësirave të sigurta për grumbullimin e punonjësve, vendosja e pajisjeve mbrojtëse dhe përdorimi i rrugëve të planifikuara për evakuim.
- Kontrolli i ndikimeve mjedisore: Marrja e masave për të parandaluar përhapjen e materialeve në zonën përreth, përfshirë mbrojtjen e lumenjve dhe sipërfaqeve tokësore.
- Stafi i trajnuar: Punonjësit trajnohen për reagime të shpejta dhe të sakta në rast emergjencash, duke përfshirë përdorimin e pajisjeve dhe protokolleve të sigurisë.
- Monitorimi dhe raportimi: Pas incidentit, dokumentimi i ngjarjes dhe monitorimi i situatës për të parandaluar pasojat e mëtejshme dhe për të përmirësuar procedurat e emergjencës.

Këto masa sigurojnë që çdo aksident ose fatkeqësi të menaxhohet në mënyrë të shpejtë dhe efektive, duke minimizuar ndikimet mbi shëndetin e punonjësve, komunitetit lokal dhe mjedisin përreth

7.3. Planet dhe zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit

Kompania “Gashi” Sh.p.k. ka parashikuar një seri planesh dhe zgjidhjesh teknike për të minimizuar ndikimet negative të projektit mbi mjedisin. Këto përfshijnë:

- Kontrolli i pluhurit dhe erozionit: Spërkatja e rrugëve dhe sipërfaqeve operative me ujë, përdorimi i mbulimeve për grumbujt e materialeve dhe organizimi i punimeve për të shmangur shpërndarjen e pluhurit në zonat përreth.
- Menaxhimi i ujërave sipërfaqësorë: Kanalizime të përkohshme dhe shtrirje të drejtueshme për të mbledhur dhe drejtuar ujërat e rrjedhshëm nga zonat operative, duke shmangur ndotjen e lumenjve dhe përroskave pranë.
- Menaxhimi i mbeturinave: Grumbullimi i mbeturinave të punonjësve në hapësira të kontrolluara dhe dërgimi i tyre për riciklim ose asgjësim sipas rregulloreve mjedisore dhe komunale.
- Rehabilitimi i zonës: Pas përfundimit të operimeve, zonat e shfrytëzuara do të rikthehen me bimësi vendase, duke rikthyer habitatet dhe duke ruajtur peizazhin lokal.
- Organizimi i zonës operative: Ndarja e hapësirave për nxjerrje, rrugë dhe vendosjen e makinerive në mënyrë të kontrolluar, duke minimizuar ndërhyrjen në zonat natyrore dhe ruajtur integritetin e tokës.
- Monitorimi dhe inspektimi: Vëzhgimi i vazhdueshëm i ndikimeve mjedisore gjatë punimeve, përfshirë pluhurin, zhurmën dhe rrjedhjen e ujërave, për të siguruar që masat mbrojtëse të funksionojnë sipas planit.

Këto plane dhe zgjidhje teknike sigurojnë që projekti të zhvillohet në përputhje me standardet mjedisore dhe të sigurisë, duke minimizuar ndikimet negative dhe duke mbështetur përdorimin e qëndrueshëm të zonës

7.4. Masat të tjera që mund të ndikojnë në parandalimin, zvogëlimin ose neutralizimin e efekteve të dëmshme në mjedis

Përveç masave ligjore dhe teknike të parashikuara, kompania “Gashi” Sh.p.k. ka parashikuar masa shtesë për të reduktuar ndikimet negative të projektit mbi mjedisin dhe komunitetin:

- Makineritë dhe pajisjet do të mirëmbahen dhe servisohen rregullisht, me qëllim shmangien e zhurmës së tepërt nga defektet teknike.

- Punimet do të zhvillohen vetëm gjatë orarit ditor, ndërsa nuk do të lejohet puna gjatë natës, të dielave dhe festave zyrtare.
- Do të shmanget mbajtja e makinerive të ndezura pa nevojë dhe përdorimi i panevojshëm i sinjaleve akustike.
- Në rast të ankesave nga banorët ose evidentimit të tejkalimit të niveleve të lejuara, do të realizohen matje të zhurmës në kufirin e parcelës dhe në drejtim të receptorëve më të afërt. Në varësi të rezultateve, do të ndërmerren masa shtesë, do të vendoset rrethoje si barrier për pengimin e zërit.
- Të gjithë kamionët që transportojnë rërë dhe zhavorr jashtë zonës së shfrytëzimit do të mbulohen me mbulesa të përshtatshme dhe të qëndrueshme, para daljes në rrugë publike.
- Trajnimi i punonjësve: Punonjësit trajnohen për përdorim të sigurt të makinerive, menaxhimin e mbeturinave dhe reagimin në situata emergjente.
- Kontrolli i qarkullimit të mjeteve: Të gjitha makineritë dhe kamionët lëvizin vetëm në rrugët e planifikuara për të minimizuar ndikimet vizuale dhe zhurmën.
- Masat për biodiversitetin: Ruajtja e hapësirave të gjelbra dhe e zonave pranë lumit Lumbardhi, rehabilitimi i sipërfaqeve të përdorura dhe mbjellja e bimëve vendase.
- Rehabilitimi do të zhvillohet në mënyrë progresive, duke filluar në pjesët ku përfundon aktiviteti i nxjerrjes, pa pritur përfundimin e plotë të jetëgjatësisë së projektit. Punimet e rehabilitimit do të përfshijnë nivelimin e sipërfaqeve të shfrytëzuara, stabilizimin e skarpave, eliminimin e depresioneve të rrezikshme, rregullimin e drenazhimit dhe rikthimin e shtresës humusore të ruajtur gjatë fazës përgatitore. Shtresa e tokës humusore do të shpërndahet në mënyrë të njëtrajtshme mbi sipërfaqet e niveluara. Pas vendosjes së humusit do të realizohet mbjellja e barit, shkurreve dhe llojeve bimë vendase, të përshtatshme për kushtet klimatike dhe pedologjike të zonës. Në skarpatat dhe pjesët me rrezik erozioni do të përdoren masa shtesë stabilizuese, duke përfshirë mbjelljen e vegjetacionit, hapjen e kanaleve të kontrolluara për ujërat atmosferike dhe, sipas nevojës, vendosjen e materialeve mbrojtëse ndaj erozionit. Sipërfaqet e rehabilituara do të kontrollohen së paku dy herë në vit gjatë dy viteve të para pas përfundimit të punimeve. Në rast të dështimit të vegjetacionit, shfaqjes së erozionit ose paqëndrueshmërisë së skarpave, kompania do të ndërmarrë masa korrigjuese dhe rimbjellje.

- Monitorimi i vazhdueshëm: Kontroll i rregullt i pluhurit, zhurmës, ujërave sipërfaqësorë dhe gjendjes së habitatit për të siguruar që masat mbrojtëse të jenë efektive.
- Parcela do të rrethohet përgjatë kufijve të zonës së shfrytëzimit. Rrethoja do të mbulohet me shirita prej materiali të gjelbër dhe të dendur, të cilët do të shërbejnë si pengesë vizuale dhe do të ndihmojnë në zvogëlimin e përhapjes së pluhurit dhe zhurmës jashtë zonës operative.



Figura 5. Rrethoja e kompanisë

- Plan i emergjencës dhe reagimit: Procedura për aksidente dhe situata fatkeqësish për të parandaluar ose zvogëluar ndikimet e menjëhershme mbi mjedisin.

Këto masa shtesë përforcojnë efektivitetin e planit mjedisor të projektit, duke siguruar që çdo ndikim i mundshëm mbi ajrin, ujin, tokën, biodiversitetin dhe komunitetin të jetë i reduktuar, i kontrolluar dhe i menaxhueshëm.

8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

8.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis

Programi i monitorimit synon të sigurojë që të gjitha aktivitetet e projektit për shfrytëzimin e materialeve inerte zhvillohen në përputhje me standardet mjedisore dhe masat mbrojtëse të parashikuara. Monitorimi përfshin vlerësimin e vazhdueshëm të faktorëve kryesorë mjedisorë dhe të ndikimeve sociale, duke siguruar identifikimin dhe menaxhimin e çdo ndikimi të mundshëm.

Elementët kryesorë të programit përfshijnë:

- Ajri: Matja e pluhurit dhe emetimeve nga makineritë dhe transporti për të monitoruar cilësinë e ajrit në zonën e projektit dhe përreth;
- Uji: Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësorë dhe rrjedhave pranë lumit Lumbardhi, për të siguruar që operimet nuk ndikojnë negativisht në ekosistemet ujore;
- Toka: Vlerësimi i erozionit, shpërndarjes së materialeve dhe gjendjes së sipërfaqeve operative;
- Biodiversiteti dhe habitatet: Inspektimi i florës dhe faunës, ruajtja e bimëve dhe specieve të zakonshme, dhe monitorimi i efektivitetit të rehabilitimit pas përfundimit të punimeve;
- Zhurma dhe trafiku: Matja e nivelit të zhurmës dhe kontrolli i lëvizjes së mjeteve brenda zonës operative;
- Mbeturinat: Kontrolli i grumbullimit, ruajtjes dhe largimit të mbeturinave sipas procedurave të parashikuara.

Programi parashikon raportim periodik tek autoritetet kompetente dhe përdorim të të dhënave për përmirësimin e masave mbrojtëse. Ky monitorim siguron që ndikimet e projektit mbi mjedisin dhe komunitetin të jenë të menaxhueshme dhe brenda kufijve të pranueshëm.

8.2. Prezantimin e gjendjes mjedisore përpara se projekti të vihet në punë ose fillimi i aktiviteteve në vendet ku ndikimi mjedisor pritet

Para se projektit për shfrytëzimin e materialeve inerte t'i jepet zbatimi, do të kryhet një vlerësim i detajuar i gjendjes aktuale të mjedisit në zonën e parcelës dhe rrethinat e saj. Ky vlerësim përfshin:

- Cilësinë e ajrit, duke matur pluhurin dhe ndotësit e mundshëm në zonat përreth;
- Gjendjen e ujërave sipërfaqësorë, duke përfshirë lumin Lumbardhi, për të përcaktuar parametrat bazë para fillimit të operimeve;

- Gjendjen e tokës dhe sipërfaqeve operative, përfshirë karakteristikat pedologjike dhe përdorimin aktual;
- Flora dhe fauna, duke dokumentuar speciet e zakonshme dhe habitatet përreth parcelës;
- Ndikimet vizuale dhe peizazhin, për të vlerësuar bazën e perceptimit vizual para fillimit të aktivitetit;
- Infrastruktura dhe rrjetin rrugor, për të përcaktuar gjendjen e rrugëve dhe aksesit për makineritë dhe transportin.

Të dhënat e mbledhura para fillimit të projektit do të përdoren si bazë krahasimi gjatë monitorimeve të mëvonshme, për të vlerësuar ndikimet reale të projektit dhe për të kontrolluar efektivitetin e masave mbrojtëse. Ky prezantim siguron që çdo ndryshim i shkaktuar nga aktiviteti i nxjerrjes të mund të identifikohet dhe menaxhohet në mënyrë të shpejtë dhe të saktë

8.3. Parametrat në bazë të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis

Për të vlerësuar ndikimet e projektit mbi mjedisin dhe për të përcaktuar efektet e mundshme dëmshme, monitorimi do të bazohet në indikatorë të ndryshëm mjedisorë. Këta përfshijnë cilësinë e ajrit, duke matur grimcat e pluhurit dhe ndotësit e tjerë nga makineritë dhe transporti, cilësinë e ujërave sipërfaqësorë dhe lumenjve pranë zonës operative, gjendjen e tokës dhe erozionin e mundshëm, biodiversitetin duke përfshirë florën, faunën dhe habitatet, nivelin e zhurmës dhe trafikun e mjeteve brenda zonës, ndikimet vizuale dhe ndryshimet në peizazh, menaxhimin e mbeturinave dhe përdorimin e burimeve ujore. Të dhënat mbi këta parametra shërbejnë si bazë për krahasim gjatë monitorimeve periodike, për të identifikuar efektet e mundshme dëmshme dhe për të vlerësuar efektivitetin e masave mbrojtëse të aplikuara.

8.4. Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar

Monitorimi i ndikimeve të projektit do të kryhet në pika të caktuara brenda dhe përreth parcelës operative për të siguruar një pasqyrë të saktë të gjendjes mjedisore. Parametrat e përcaktuar do të matin cilësinë e ajrit, ujërave sipërfaqësorë, gjendjen e tokës, biodiversitetin, nivelin e zhurmës dhe menaxhimin e mbeturinave.

Matjet e ajrit do të kryhen në pika pranë rrugëve operative dhe afër vendbanimeve më të afërta për të identifikuar shpërndarjen e pluhurit dhe ndotësve. Cilësia e ujërave do të monitorohet pranë lumenjve dhe përroskave, duke përfshirë lumin Lumbardhi, për të vlerësuar çdo ndikim nga aktivitetet operative. Gjendja e tokës dhe erozioni do të vlerësohen në hapësirat operative dhe në zonat rreth parcelës. Biodiversiteti do të monitorohet në habitatet e florës dhe faunës pranë parcelës dhe lumin Lumbardhi, ndërsa zhurma dhe trafiku do të regjistrohen përgjatë rrugëve operative dhe rrugëve të qarkullimit të mjeteve të rënda.

Shpeshtësia e matjeve është e përshtatur sipas natyrës së parametrave: matjet e ajrit dhe ujit do të kryhen periodikisht, me frekuencë mujore ose tremujore, ndërsa inspektimet e tokës, florës, faunës dhe peizazhit do të kryhen të paktën një herë në gjashtë muaj ose sipas nevojës gjatë periudhave aktive të operimeve. Të dhënat e mbledhura do të dokumentohen dhe raportohen tek autoritetet kompetente për të siguruar që masat mbrojtëse të jenë efektive dhe ndikimet e projektit të jenë të menaxhueshme

8.5.Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera

Raportet për matjet e kryera në kuadër të programit të monitorimit të ndikimeve mjedisore do të përmbajnë të dhënat e mbledhura për të gjithë parametrat e përcaktuar, përfshirë cilësinë e ajrit, ujërave sipërfaqësorë, gjendjen e tokës, biodiversitetin, zhurmën, trafikun dhe menaxhimin e mbeturinave. Çdo raport do të përmbajë analizën e të dhënave, krahasimin me vlerat bazë para fillimit të projektit, vlerësimin e ndikimeve dhe rekomandimet për masat korrigjuese ose përmirësuese.

Dorëzimi i raporteve kryhet periodikisht sipas natyrës së parametrave dhe frekuencës së matjeve. Raportet mujore ose gashtemujore dërgohen tek autoritetet kompetente për ajrin, ujin dhe mbeturinat, ndërsa inspektimet e gjendjes së tokës, florës dhe faunës raportohen të paktën një herë në gjashtë muaj ose sipas nevojës gjatë periudhave aktive të operimeve. Raportet për zhurmën dhe trafikun dorëzohen pas çdo periudhe monitorimi sipas programit të përcaktuar. Kjo strukturë e dorëzimit siguron një vlerësim të vazhdueshëm të ndikimeve të projektit mbi mjedisin dhe lejon ndërhyrje të shpejta për të minimizuar efektet negative, duke garantuar përputhshmërinë me legjislacionin mjedisor dhe standardet operacional

8.6.Detyrimi për të informuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera

Kompania “Gashi” Sh.p.k. ka detyrimin të sigurojë transparencë ndaj publikut për rezultatet e matjeve të kryera gjatë operimit të projektit. Të dhënat e mbledhura për cilësinë e ajrit, ujërave sipërfaqësorë, gjendjen e tokës, biodiversitetin, zhurmën, trafikun dhe menaxhimin e mbeturinave do të publikohen në mënyrë të rregullt, përmes raporteve periodike të aksesueshme për komunitetin lokal dhe institucionet përkatëse.

Informimi publik synon të rrisë ndërgjegjësimin mbi ndikimet e mundshme të projektit, të sigurojë pjesëmarrje dhe feedback nga komuniteti, dhe të demonstrojë respektimin e masave mbrojtëse dhe standardeve ligjore dhe mjedisore.

8.7.Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis

Projekti nuk ndodhet pranë kufijve shtetërorë, prandaj nuk ka ndikime ndërkufitare dhe nuk kërkohet monitorim specifik në këtë drejtim.

9. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

9.1.Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit

Plani i menaxhimit mjedisor synon që të gjitha aktivitetet e projektit për shfrytëzimin e materialeve inerte të zhvillohen në mënyrë të qëndrueshme dhe me ndikim minimal mbi mjedisin dhe komunitetin. Gjatë gjithë fazave të projektit, nga përgatitja e parcelës, nxjerrja dhe transporti i materialeve, deri te rehabilitimi pas përfundimit të operimeve, do të zbatohen masat mbrojtëse të planifikuara, duke përfshirë kontrollin e pluhurit, menaxhimin e ujërave sipërfaqësorë, monitorimin e biodiversitetit dhe rehabilitimin e sipërfaqeve të përdorura.

Gjithashtu, do të respektohen procedurat për sigurinë e punonjësve dhe komunitetit, duke përfshirë rrugët operative të kontrolluara, përdorimin e makinerive të mirëmbajtura, monitorimin e zhurmës dhe trafikut, si dhe trajtimin e mbeturinave sipas standardeve ligjore. Ky plan siguron që ndikimet negative të mbeten të menaxhueshme dhe që projekti të zhvillohet në përputhje me standardet mjedisore dhe ligjore.

9.2.Pajtushmeria me pëlqim mjedisor

Gjatë zbatimit të projektit, kompania “Gashi” Sh.p.k. do të veprojë në përputhje të plotë me pëlqimin mjedisor të dhënë nga autoritetet kompetente. Të gjitha masat mbrojtëse dhe planet e menaxhimit mjedisor do të zbatohen siç janë përcaktuar në dokumentacionin e miratuar, duke siguruar që operimet e nxjerrjes së materialeve inerte të zhvillohen në mënyrë të qëndrueshme, të sigurt dhe pa shkelur rregulloret ligjore dhe mjedisore.

Monitorimi i vazhdueshëm, raportimi tek autoritetet dhe implementimi i masave korrigjuese sipas rekomandimeve të pëlqimit mjedisor garantojnë që projekti të mbetet në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore gjatë të gjithë ciklit të tij.

9.3.Inkurajimi I zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000

Projekti synon të promovojë dhe zbatojë një sistem të menaxhimit mjedisor që përputhet me standardin ISO 14000, duke siguruar që të gjitha aktivitetet e shfrytëzimit të materialeve inerte të jenë të planifikuara dhe të kontrolluara në mënyrë efektive. Ky sistem përfshin identifikimin e ndikimeve mjedisore, përcaktimin e masave mbrojtëse, monitorimin e vazhdueshëm dhe përmirësimin e procedurave operative.

Zbatimi i standardit ISO 14000 garanton menaxhim të qëndrueshëm të burimeve, minimizim të ndikimeve negative, përputhje me ligjin dhe transparencë ndaj autoriteteve dhe komunitetit. Përmes këtij sistemi, kompania mund të përmirësojë performancën mjedisore, të reduktojë rreziqet dhe të sigurojë zhvillim afatgjatë të projektit në harmoni me mjedisin.

10. INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT

10.1. Informacionet dhe karakteristikat shitesë të projektit për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM -së,

Ky nënkapitull përmban informacion shitesë dhe karakteristika të veçanta të projektit që ndihmojnë në përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM-së. Përfshihen detaje mbi kapacitetin e nxjerrjes së materialeve inerte, hapësirat operative, organizimin e rrugëve dhe platove, shfrytëzimin e sipërfaqeve, masat mjedisore dhe planin e menaxhimit të tyre, si dhe elemente që lidhen me sigurinë, monitorimin dhe rehabilitimin e zonës.

Këto informacione shërbejnë si bazë për vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale të projektit dhe sigurojnë që raporti të jetë i plotë, i qartë dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vlerësimit të ndikimit në mjedis

10.2. Baza ligjore dhe rregullative

Hartimi i këtij Raporti të VNM-së është mbështetur në kornizën ligjore të Republikës së Kosovës, e cila është e harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian për industrinë nxjerrëse dhe mbrojtjen e mjedisit.

Ligjet dhe Udhëzimet Administrative

- Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis: Ligji bazë që rregullon
- Procedurat e Raportit të Vlerësimit të ndikimit në Mjedis
- Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit: Përcakton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.
- Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet (i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158): Rregullon shfrytëzimin e resurseve minerale.
- Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja: Për limitet e pluhurit dhe gazeve.
- Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina: Për menaxhimin e mbeturinave (Ndryshohet/Plotësohet nga Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-060 për mbeturina).
- Ligji Nr. 04/l-147 për ujërat e Kosovës
- Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma: Për limitet akustike në zona të banuara.
- Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës: Për ruajtjen e biodiversitetit

Udhëzimet Administrative (UA):

- UA Nr. 07/2021: Për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër.
- UA Nr. 08/2009: Për vlerat kufitare të zhurmës.

- UA Nr. 04/2025: Për përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore, praktikat e zbatueshme dhe aspektet e tjera teknike të raportit
- UA Nr. 04/2025 për përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore , praktikat e zbatueshme dhe aspektet e tjera teknike të raportit

10.3. Dokumentacioni teknik

Dokumentacioni teknik përfshin të gjitha planet, vizatimet, specifikimet dhe udhëzimet e nevojshme për zbatimin e projektit të zonës së eksploatimit të inerteve. Ai përfshin:

- Plani i detajuar i lokacionit dhe i frontit të punës;
- Skicat dhe planimetria e zonës së eksploatimit dhe rrugëve të brendshme;
- Specifikimet teknike për përdorimin e makinerive dhe pajisjeve minerare;
- Procedurat për sigurinë në punë dhe masat për mbrojtjen e mjedisit;
- Udhëzimet për kontrollin e pluhurit, zhurmës, vibrimeve dhe ujërave të ndotura;
- Planet për situata emergjente dhe masat për reagim në raste aksidentesh.

Ky dokumentacion shërben si bazë për zbatimin e kontrolluar dhe të sigurt të projektit, duke siguruar përputhshmëri me standardet teknike dhe ligjore.

11. BURIMET E TË DHËNAVE

11.1. Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- Te dhënat nga Investitori,
- Projekti Konceptual,
- [Kërko dhe paraqit - KGP \(rks-gov.net\)](#)
- [Peja to Balkans - Google Maps](#)
- [Plani Zhvillimor Komunal i Pejës 2020-2028 \(rks-gov.net\)](#)
- [LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS \(rks-gov.net\)](#)

12. SHTOJCA

1. Raporti i VNM-së i nënshkruar nga aplikuesi dhe personi fizik apo juridik i pajisur me licencë nga Ministria për hartimin e raporteve të VNM-së, me një (1) kopje në formë të shkruar dhe një (1) kopje në formë elektronike.
2. Dëshmia e pagesës për aplikim për pëlqim mjedisor.
3. Vlera investive e projektit në formë tabelare.
4. Certifikata e regjistrimit të biznesit.
5. Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme.
6. Kopja e planit me koordinata në sistemin Kosova Ref.
7. Plani i rilevimit të terrenit nga gjeodeti i licencuar, si dhe kopja e licencës së gjeodetit.
8. Kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e ngastrës ose objektit, në rastet kur ngastra ose objekti nuk është pronë e aplikuesit.
9. Pëlqimi mjedisor paraprak
10. Pëlqimi i Komunës për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftim/informimi sipas Planit Zhvillimor Komunal, Hartës Zonale dhe kushteve ndërtimore.
11. Licenca valide e personit fizik ose juridik, e lëshuar nga Ministria.

13. PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE E INFORMACIONIT

13.1. Hyrje

Kjo përmbledhje jo teknike paraqet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme informacionet kryesore lidhur me projektin e kompanisë “Gashi” Sh.p.k. për eksploatimin sipërfaqësor të materialeve inerte, kryesisht rërës dhe zhavorrit, në territorin e Komunës së Pejës.

Qëllimi i përmbledhjes është që publiku dhe palët e interesuara të informohen për karakteristikat kryesore të projektit, mënyrën e zhvillimit të aktivitetit, ndikimet e mundshme në mjedis, masat e planifikuara për zvogëlimin e tyre, programin e monitorimit dhe përfitimet socio ekonomike.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis analizon ndikimet e mundshme në ajër, ujë, tokë, biodiversitet, peizazh, shëndetin e njeriut, trafik dhe mjedisin përreth. Në raport janë përcaktuar masa parandaluese dhe korrigjuese për të siguruar që aktiviteti të zhvillohet në mënyrë të kontrolluar dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe mjedisore.

13.2. Përshkrimi i Projektit

Projekti parashikon eksploatimin sipërfaqësor të rërës dhe zhavorrit nga parcela kadastrale nr. P-71611071-05611-0, Zona Kadastrale Pejë, Komuna e Pejës. Sipërfaqja e paraparë për shfrytëzim është rreth 0.6749 ha, ndërsa vëllimi i planifikuar i nxjerrjes është rreth 30,000 m³ në vit.

Procesi i punës përfshin përgatitjen e terrenit, largimin dhe ruajtjen e shtresës humusore, gjurmimin mekanik të materialit, ngarkimin e tij me ekskavator ose ngarkues frontal dhe transportimin me kamionë drejt destinacionit përfundimtar. Në lokacion nuk parashihet thërrmimi, seleksionimi, sitja ose larja e materialit. Aktiviteti përfshin vetëm nxjerrjen, ngarkimin dhe transportimin e rërës dhe zhavorrit.

Zona e punimeve ndodhet rreth 420 m larg shtëpisë më të afërt të banimit dhe rreth 270 m nga lumi Lumbardhi i Pejës. Këto distanca, së bashku me zbatimin e masave mbrojtëse, ndikojnë në kufizimin e ndikimeve të mundshme ndaj popullsisë dhe burimeve ujore.

Uji nuk do të përdoret për përpunimin ose larjen e materialit. Ai do të përdoret vetëm për kontrollin e pluhurit. Gjatë periudhave të thata, rrugët e brendshme, zonat e ngarkimit dhe sipërfaqet operative do të spërkaten së paku dy herë në ditë. Furnizimi do të realizohet nga rrjeti rajonal i ujësjellësit, ndërsa gjatë kufizimeve sezonale uji do të sigurohet përmes autocisternave.

Punimet do të zhvillohen vetëm gjatë orarit ditor. Nuk do të lejohet puna gjatë natës, të dielave dhe festave zyrtare. Pas përfundimit të aktivitetit, zona do t'i nënshtrohet rehabilitimit dhe rikultivimit progresiv.

13.3. Ndikimet kryesore mjedisore dhe masat mbrojtëse

Projektit ka disa ndikime kryesore mbi mjedisin, për të cilat janë planifikuar masa mbrojtëse të veçanta:

1. Ajri

- **Ndikimi:** Shpërndarja e pluhurit gjatë nxjerrjes dhe transportit të materialeve.
- **Masat mbrojtëse:** Spërkatja e rrugëve dhe sipërfaqeve operative, përdorimi i mbulimeve për grumbujt e materialeve, monitorimi i pluhurit dhe ndjekja e përqendrimeve.

2. Zhurma dhe trafiku

- **Ndikimi:** Zhurma nga makineritë dhe qarkullimi i kamionëve dhe mjeteve të rënda.
- **Masat mbrojtëse:** Qarkullim i kontrolluar në rrugët brenda parcelës, përdorim i makinave të mirëmbajtura, limitim i lëvizjeve gjatë orëve të ndjeshme për komunitetin.

3. Uji

- **Ndikimi:** Ndikimi i mundshëm mbi lumenjtë dhe përroskat pranë zonës për shkak të ujërave sipërfaqësorë.
- **Masat mbrojtëse:** Kanalizime të përkohshme dhe drejtueshme, mbledhja dhe drejtimi i ujërave sipërfaqësorë jashtë zonave të ndotura, monitorimi i lumenjve dhe përroskave.

4. Tokë dhe erozion

- **Ndikimi:** Ndryshime në sipërfaqe dhe mundësi e erozionit.
- **Masat mbrojtëse:** Organizimi i punimeve brenda parcelës, vendosja e barrierave për erozionin, rehabilitimi i tokës pas përfundimit të operimeve.

5. Biodiversiteti dhe habitatet

- **Ndikimi:** Ndërhyrja në habitatet e florës dhe faunës.
- **Masat mbrojtëse:** Ruajtja e hapësirave pranë lumit Lumbardhi, rehabilitimi i sipërfaqeve me bimësi vendase, monitorimi i florës dhe faunës, minimizimi i ndërhyrjes në habitatet ekzistuese.

6. Mbetjet dhe mbeturinat

- **Ndikimi:** Grumbullimi i materialeve të pavlefshme dhe mbeturinave operative.
- **Masat mbrojtëse:** Menaxhimi i mbeturinave sipas standardeve ligjore, grumbullim i kontrolluar dhe largim për riciklim ose asgjësim.

Këto masa sigurojnë që ndikimet negative të mbeten të menaxhueshme, duke ruajtur integritetin e mjedisit dhe peizazhit lokal, ndërsa aktivitetet zhvillohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të kontrolluar.

13.4. Përfitimet socio-ekonomike

PRealizimi i projektit pritet të sjellë përfitime ekonomike dhe sociale për kompaninë, komunitetin lokal dhe sektorin e ndërtimit. Projekti mundëson furnizimin me rërë dhe zhavorr për ndërtimin e objekteve, rrugëve dhe projekteve të tjera infrastrukturore.

Aktiviteti do të kontribuojë në krijimin dhe ruajtjen e vendeve të punës për operatorë të makinerive, shoferë, staf teknik dhe punonjës të tjerë mbështetës. Gjithashtu, projekti do të krijojë kërkesë për shërbime lokale, përfshirë transportin, mirëmbajtjen e makinerive, furnizimin me karburant dhe shërbime të tjera ndihmëse.

Përfitimet e tjera përfshijnë:

- rritjen e aktivitetit ekonomik lokal;
- furnizimin e tregut me materiale ndërtimore;
- rritjen e të hyrave nga taksat dhe detyrimet përkatëse;
- angazhimin e operatorëve dhe bizneseve lokale;
- mbështetjen e zhvillimit të infrastrukturës në nivel lokal dhe rajonal.

Zbatimi i masave mbrojtëse dhe rehabilitimi progresiv i zonës synojnë që këto përfitime të realizohen pa shkaktuar ndikime të papranueshme në mjedis dhe në cilësinë e jetës së komunitetit.

13.5. Përfundimi

Projekti i shfrytëzimit të materialeve inerte në zonën e Pejës është i organizuar dhe i menaxhuar në mënyrë që aktivitetet të zhvillohen në mënyrë të qëndrueshme dhe me ndikim minimal mbi mjedisin dhe komunitetin. Masat mbrojtëse dhe planet e menaxhimit mjedisor sigurojnë kontrollin e pluhurit, ujërave, mbeturinave, zhurmës dhe ndikimeve mbi florën, faunën dhe peizazhin. Programi i monitorimit dhe rehabilitimi i sipërfaqeve garantojnë që çdo ndikim të jetë i menaxhueshëm dhe që zonat e përdorura të rikthehen në gjendje të qëndrueshme.

Projekti sjell gjithashtu përfitime socio-ekonomike për komunitetin lokal dhe rajonal, duke krijuar vende pune, furnizuar sektorin e ndërtimit dhe stimuluar aktivitetin ekonomik. Në përputhje me standardet ligjore dhe mjedisore, projekti ofron një balancë midis zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së mjedisit, duke siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe përfitime të qëndrueshme për zonën përreth.